



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/25  
Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Propozohen kandidatët për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si në vijim:
  - 1.1. Hasime Mazreku;
  - 1.2. Skender Komoni;
  - 1.3. Ranko Djokic;
  - 1.4. Qemajl Behrami;
  - 1.5. Bekim Selimaj;
  - 1.6. Avni Ajdini.
2. Vendimi, bashkë me biografite e kandidatëve, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 02/25  
Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Kryeministrit të emërojë z. Fadil Kodra, Drejtor të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 03/25

Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komisionit të Ankesave për të Huajt, i themeluar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/26 të datës 4 maj 2015, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 07/89 të datës 25 maj 2016 dhe me vendimin nr. 11/122 të datës 23 dhjetor 2016.
2. Sipas këtij ndryshimi dhe plotësimi, Komisioni i Ankesave për të Huajt ka këtë përbërje:
  - 2.1. Agron Gashi, Zyra e Kryeministrit - kryesues;
  - 2.2. Zana Selimi, Ministria e Drejtësisë - zv. kryesuese;
  - 2.3. Nexhat Llapaj, Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
  - 2.4. Jeton Maliqi, Ministria e Punëve të Jashtme - anëtar;
  - 2.5. Zemrie Limaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - anëtare;
  - 2.6. Valon Berisha, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtar;
  - 2.7. Bashkim Shala, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - anëtar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/25  
Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 73 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të nenit 18 të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit me nr. protokollit 3829 të datës 27.12.2017, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e rastit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në këtë përbërje:
  - 1.1. Dardan Gashi, Zëvendëskryeministër, kryesues;
  - 1.2. Mahir Yagcilar, Ministër i Administratës Publike, anëtar;
  - 1.3. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë, anëtar;
  - 1.4. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH, anëtar;
  - 1.5. Fitim Sadiku, Sekretar i Përgjithshëm i MPJ, anëtar.
2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me Rregulloren nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera përcjellëse.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 05/25  
Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në 'Erasmus +', programin e Unionit për arsim, trajnim, rini dhe sport.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/25  
Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga Ndërtimi i Rrugës Nacionale N 9 Prishtinë - Pejë, Segmenti Balincë - Pejë, Zona Kadastrale Balincë, Komuna Malishevë, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë paraqet pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

  
Ramush HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/25  
Datë: 22.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Rrugës Rajonale R 129 Kërpimëh - Mitrovicë", Zonat Kadastrale Revuq dhe Pakashticë e Poshtme të Komunës së Podujevës, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë